



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 822/2 prot.

Tiranë, më 13 . 06 . 2022

**V E N D I M**

**Nr. 117 , datë 13 . 06 . 2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, është paraqitur ankesa nr. 87 Regj., datë 31.05.2022, e shtetasit D. L, kundër Këshillit të Qarkut Durrës, me pretendim diskriminimin për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se subjekti ankues, me datë 05.06.2007, ka lidhur marrëdhënien e punës me Këshillin e Qarkut Durrës, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Shërbimeve Rajonale.

Bazuar në Vendimin nr. 44, datë 16.12.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, “*Për largimin nga Shërbimi Civil*”, punëdhënësi me datë 20.12.2013, ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien e punës me subjektin ankues.

Ndodhur në këto kushte, ankuesi ka kundërshtuar gjyqësisht largimin e tij nga puna, dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të pretendimeve të tij, Gjykata Administrative e Shkallës së

<sup>1</sup> Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Parë Durrës, me Vendimin nr. 309, datë 31.03.2014 ka disponuar, ndër të tjera: *“Shfuqizimin e Vendimit nr. 44, datë 31.03.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, për pjesën që ka të bëjë me paditësin D. L. Rikthimin në punë të paditësit në pozicionin e tij të punës dhe detyrimin e të paditurit t’i paguajë pagën dhe përfitimet e tjera nga momenti i shkëputjes të marrëdhënieve financiare deri në momentin e rikthimit në detyrë të paditësit”*.

Vendimi sipërcituar është apeluar nga punëdhënësi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me Vendimin nr. 4361, datë 02.12.2014 ka disponuar, ndër të tjera: *“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Vendimit nr. 44, datë 16.02.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës. Kthimin e paditësit D. L në vendin e mëparshëm të punës. Detyrimin e palës së paditur, Këshillit të Qarkut Durrës t’i paguajë paditësit D. L pagën nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, datë 20.12.2013, deri në datën e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës”*.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs Këshilli i Qarkut Durrës, lidhur me të cilin, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë<sup>2</sup>, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur, Këshilli i Qarkut Durrës, ndaj Vendimit nr. 4361, datë 02.12.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”*.

Në vitin 2015, ankuesi shprehet se i është drejtuar Shërbimit Përmbartimor Privat, i cili me datë 20.01.2015 ka nisur lajmërimin për ekzekutimin vullnetar, duke ndjekur më pas të gjitha procedurat bazuar në Kodine Procedurës Civile.

Ankuesi shprehet se që nga vënia në ekzekutim e vendimit të Gjykatës së Apelit e deri në momentin e paraqitjes së kësaj ankese pranë KMD-së, nuk i është paguar asnjë masë e detyrimit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës, duke pretenduar se ky trajtim i bëhet atij nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, vetëm për shkak të bindjeve politike që ka, të ndryshme me titullarin e këtij Institucioni.

Bazuar në vërtetimet e lëshuara nga Partia Republikane e Shqipërisë (PRSH), rezulton se ankuesi ka qenë anëtar i kësaj partie që prej vitit 1996. Nga viti 2011 deri në vitin 2018 ka qenë Sekretar i kësaj partie për Degën Durrës, sekretar i Këshillit Politik për Qarkun Durrës si dhe anëtar i Asamblesë Kombëtare të PRSH.

Subjekti ankues, ndër të tjera, është shprehur se, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në të cilin u vendos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës dhe detyrimi i punëdhënësit për pagimin e pagës deri në rikthimin e tij në punë, ky detyrim nuk është zbatuar në kushtet e ekzistencës së shkakut të diskriminimit, për

---

<sup>2</sup> Vendimi nr. 1564, datë 21.10.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

bindjet e tij politike, duke u shprehur se: “...në kundërshtim me ligjin material më është ofruar rikthimi në punë në mënyrë tallëse, diskriminuese dhe të papërshtatshme me formimin tim, në një kategori page shumë më të ulët se ajo që kisha në momentin e largimit nga puna”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehimisht:

- “Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.
- Pagimin e pagave dhe rikthimin në punë, sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës”.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

- Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi, rezulton se, pretendimet për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë ai i ka ndjekur sipas procedurës së përcaktuar në ligj, përmes Përmbarduesit Gjyqësor.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbardimit Gjyqësor”*, i ndryshuar, në nenin 2<sup>3</sup>, të tij, ka përcaktuar se:

*“1. Shërbimi i Përmbardimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.*

*2. Shërbimi i Përmbardimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbarduesve gjyqësorë”.*

Pika 1, e nenit 5<sup>4</sup>, të këtij Ligji përcakton se:

*“Përmbarduesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.*

Neni 35<sup>5</sup>, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbardimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, ngarkon me përgjegjësi, me shkarkim nga detyra, përmbarduesin gjyqësor, duke përcaktuar se:

*“1. Përmbarduesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:*

*a) kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;*

*b) kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;*

*c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;*

*ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;*

*d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;*

*dh) kur nuk përmbush veprimet përmbardimore të parashikuara në ligj;*

*e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji”.*

---

<sup>3</sup> Objekti i veprimtarisë

<sup>4</sup> Përmbarduesi gjyqësor

<sup>5</sup> Shkarkimi

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se:

*“ Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.*

*Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbaruesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit”.*

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbaruesi gjyqësor.

- Me shkresën me nr. 4141 prot., datë 20.01.2015, Shoqëria Përmbarimore Private “Hoti Bailifi Service” shpk, ka iniciuar procedurën për ekzekutimin vullnetar të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.
- Gjatë ndjekjes së procedurës së ekzekutimit vullnetar të vendimit sipërcituar, në kushtet kur ai nuk ka ndodhur, pas kalimit të afatit për ekzekutim vullnetar, Përmbaruesi Gjyqësor ka filluar procedurën për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit.

Pra, në këtë kontekst, në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, përmbaruesi gjyqësor (*si pjesë e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë*), ka përmbushur detyrimin e tij në zbatim të detyrave funksionale, konform përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, të ndryshuar.

- Evidentohet se veprimet procedurale të Përmbaruesit Gjyqësor për ekzekutimin e këtij vendimi për llogari të ankuesit kanë vijuar për disa vite dhe aktualisht, ky vendim mbetet i paekzekutuar ende (*edhe gjatë shqyrtimit të ankesës pranë KMD-së*).

Pra, subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e ish-punëdhënësit/Këshillit të Qarkut Durrës, lidhur me faktin e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që me datë 20.01.2015 (duke konsideruar edhe veprimet e mëvonshme procedurale të ndjekura në vijim të vitit 2016), kur është kërkuar ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit.

- Në kontekst të sa mësipër, ankuesi ka marrë dijeni për moszbatimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, lidhur me pagimin e pagave sipas këtij vendimi dhe rikthimin e tij në vendin e punës (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), që gjatë 2015-2016, (kur bazuar në komunikimet shkresore të ish-punëdhënësit/Këshillit të Qarkut Durrës, ka konsideruar vendimin si të pazbatuar, dhe për këtë arsye, Përmbaruesi Gjyqësor ka vijuar me procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm deri dhe gjorbitjen e subjektit për moszbatim të vendimit të formës së prerë të Gjykatës. Komisioneri vlerëson momentin e parë të marrjes dijeni për moszbatimin e tij, pasi ky vendim vijon të mbetet i paekzekutuar edhe aktualisht pas gati 8 vitesh, nga marrja e formës së prerë të tij). Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 31.05.2022, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit D. L, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet proçedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri vëren se, nisur nga kërkimet e subjekti ankues, të cilat në thelb i referohen pagimit të pagave sipas Vendimit përkatës të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nga data 20.12.2013, deri në datën e rikthimit në vendin e mëparshëm të punë dhe rikthimin e tij në punë; ankuesi, si subjekt i interesuar, mund t’i drejtohet drejtëpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 131, pika 1, shkronja f) e tij, ka parashikuar se:

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

.....f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Pika 1, shkronja i) e pika 2, e nenit 134, të Kushtetutës, përcaktojnë shprehimisht se:

*“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:*

*.....i) individëve.*

*2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”.*

Neni 44 i Kushtetutës përcakton se:

*“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.*

Bazuar në sa më lart, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, individët e prekur drejtëpërdrejtë, mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Për rrjedhojë, edhe subjekti ankues, i ndodhur në këto kushte, mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me pretendimin e tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga viti 2014 e deri aktualisht (*Referuar Vendimit nr. 4361, datë 02.12.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*).

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/dh, të ligjit nr.10/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues D. L, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike

Lloji i vendimit: Mospranim